



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_ 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*Datë: 18.05.2021*

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “**ECS ECO CLIMATE SOLUTION**” SHPK SHPK & “**EDMELI**” SHPK;

*Me adresë të OE: “ecs Eco Climate Solution” SHPK: Njesia Bashkiake nr.7, Zona 17, Rruga e Kavajes, pall.2R Nr. 4, shk.3 , ap.7, Kati 0, Tiranë;*

*Me adresë të OE: “EDMELI” SHPK: Komuna Farkë, Tiranë;*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” me objekt: “Riparim, mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve për Kryeministrinë”, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **27,343,934 (njëzet e shtatë milion e treqindë e dyzetë e tre mijë e nëntëqindë e tridhjetë e katër) Lekë (pa TVSH).**

Numri i referencës: **REF-91921-03-30-2021.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Riparim, mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve për Kryeministrinë**”, me fond të marrëveshjes kuadër: 27,343,934 (njëzet e shtatë milion e treqindë e dyzetë e tre mijë e nëntëqindë e tridhjetë e katër) Lekë (pa TVSH), Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, sipas marrëveshjes kuadër.

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:** 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme ( jo ): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 49 datë 06 Prill 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë operatorët ekonomikë me vlerën përkatëse të ofruar:

1) **BOE “ECS ECO CLIMATE SOLUTION” & “EDMELI” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L22218013G**

**J91524018T**

*numri i NIPT-it*

Vlera: **25,701,320** (njëzet e pesë milion e shtatëqind e një mijë e treqind e njëzet) lekë (pa TVSH).  
*(me numra dhe fjalë).*

2) **BOE “GSM KLIMARE” SHPK &**

**L26804206O**

**“ADMIR” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera: **22,755,600** (njëzet e dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë gjashtëqind) lekë (pa TVSH).

*(me numra dhe fjalë).*

**K82509006P**

*numri i NIPT-it*

**3) BOE “SUPERIOR GROUP KLIMA” SHPK &  
“LEON KONSTRUKSION” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera: **23,839,200** (njëzet e tre milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë (pa TVSH).

*(me numra dhe fjalë).*

**K91712015L**

**K71820009I**

*numri i NIPT-it*

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

**1) BOE “GSM KLIMARE” SHPK &  
“ADMIR” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L26804206O**

**K82509006P**

*numri i NIPT-it*

**2) BOE “SUPERIOR GROUP KLIMA” SHPK &  
“LEON KONSTRUKSION” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K91712015L**

**K71820009I**

*numri i NIPT-it*

#### **1. Arsyeja e skualifikimit për BOE “GSM KLIMARE” SHPK & “ADMIR” SHPK**

- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.1 “Per kapacitetin ligjor/profesional” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi anëtari i BOE “ARDMIR” shpk, i cili sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, merr përsipër të kryejë 49% të cdo zëri të punimeve, nuk rezulton të jetë i pajisur me licensë profesionale që lidhet me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë: NS12-A *Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit* dhe NS-3A *Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)*, ndërsa anëtari i BOE “GSM Klimate” shpk, i cili sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, merr përsipër të kryejë 51% të cdo zëri të punimeve, nuk rezulton të jetë i pajisur me licensë profesionale që lidhet me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë NS-14 A *Impiante te brendshme elektrike*.
- BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të seksionit 2.1 “Per kapacitetin ligjor/profesional” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi anëtari i BOE “ARDMIR” shpk, i cili sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, merr përsipër të kryejë 49% të cdo zëri të punimeve, rezulton të jetë i pajisur me Certifikatat ISO 9001, OHSAS 18001 ose ISO 45001 dhe ISO 14001 ose ekuivalente të tyre, të cilat nuk janë sipas fushës së objektit që prokurohet.
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi inxhinieri hidroteknik A.K., për të cilin anëtari i BOE “ARDMIR” shpk ka paraqitur kontratë pune dhe diplomën përkatëse, nuk rezulton të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë “ARDMIR” sh.p.k..
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6 të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi për pjesë këmbimi të impianteve VRV IV ose ekuivalent, në gjuhën shqipe. Sipas pikës 4.6 të Seksionit 4 “Procedura” të Njoftimit të Kontratës të DST, është përcaktuar se gjuha për hartimin e ofertave është gjuha shqip. Ofertuesi ka paraqitur dokumentin e emërtuar në SPE “Autorizim”, në përmbajtje të të cilit rezulton një dokument në gjuhën angleze, i papërkthyer në gjuhën shqipe sipas formës së kërkuar nga ligji.

## 1. Arsyeja e skualifikimit për BOE “SUPERIOR GROUP KLIMA” SHPK & “LEON KONSTRUKSION” SHPK

- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën dh), pika 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi anëtari i BOE “Superior Group Klima” shpk nuk arriti të provojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik. Referuar Vërtetimit të Debitit datë 07.01.2021 të paraqitur në SPE nga anëtari i BOE “Superior Group Klima” shpk, rezultoi se ky i fundit nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajt Dhjetor 2020, Janar 2021 dhe Shkurt 2021.
- BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të seksionit 2.1 “Per kapacitetin ligjor/profesional” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi anëtari i BOE “Leon Konstruksion” shpk, i cili sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit merr përsipër të kryejë zërat e punimeve (Pastrim i baterive të kondesimit, modulet e jashtme VRV dhe Kontroll dhe pastrim i vasketës së kondesimit), rezultoi të jetë i pajisur me Certifikatat ISO 9001, OHSAS 18001 ose ISO 45001 dhe ISO 14001 ose ekuivalente të tyre, të cilat nuk janë sipas fushës së objektit që merr përsipër të realizojë.
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 gërma a) të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi anëtari i BOE “Leon Konstruksion” shpk, nuk ka paraqitur Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për muajin Mars 2021, të konfirmuara nga administrata tatimore.
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 gërma b) të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi anëtarët e BOE kanë paraqitur Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, por pa përfshirë të dhënat për muajin Mars 2021.
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 5 /1 dhe 5/2 të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për automjete transporti dhe makineri ngritëse, sic kërkohet në DST.
- BOE nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6 të seksionit 2.3 “Per kapacitetin teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi për pjesë këmbimi të impianteve VRV IV ose ekuivalent.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

**BOE “ECS ECO CLIMATE SOLUTION” &  
“EDMELI” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L22218013G**

**J91524018T**

*numri i NIPT-it*

Me vlerë të ofertuar: **25,701,320** (njëzet e pesë milion e shtatëqind e një mijë e treqind e njëzet) lekë (pa TVSH), me adresë: Njesia Bashkiake nr.7, Zona 17, Rruga e Kavajes, pall.2R Nr. 4, shk.3, ap.7, Kati 0, Tiranë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë, Tel: 042 247 865, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.05.2021.

Ankesa: Jo

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

